

## Fatmir (Fahri) Berisha

(16.09.1969, shqiptar nga Prizreni/Prizren, shofer, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Fatmiri jetonte me familjarët e vet në lagjen *Bajram Curri* në Prizren. U bë pjesëtar i UÇK-së shumë herët, por familja e tij nuk kishte njohuri për këtë për një kohë të gjatë. Ishte pjesëtar i policisë ushtarake pranë shtabit të UÇK-së në Jeshkovë/Ješkovo. Në datën **1.09.1998**, Fatmiri u plagos rëndë gjatë betejës me forcat serbe në **Jeshkovë/Ješkovo**. Bashkëluftëtarët e kanë bartur në Hoçën e Qytetit/Hoča Zagradka. Për shkak të sulmit të forcave serbe, atje nuk kishte asnjë mjek dhe, rrjedhimisht, Fatmiri ndërroi jetë në të njëjtën natë. Bashkëluftëtarët e kanë varrosur më 3.09.1998 në varrezat e Hoçës së Qytetit/Hoča Zagradka. Pas lufte, më 15.09.2000, mbetjet mortore të Fatmirit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Landovicë/Landovica.

**Burimet:** deklarata S.B, FDH-26799; J. Martinsen, *Regjistri..*, FDH-26092.

## Tamil (Beqir) Shala

(15.07.1956, shqiptar nga Kushtendili/Kuštendil, komuna e Prizrenit/Prizren, korrier, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

## Refki (Gani) Shala

(8.10.1970, shqiptar nga Kushtendili/Kuštendil, komuna e Prizrenit/Prizren, bujk, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

## Milaim (Xhemali) Thaqi

(29.01.1971, shqiptar nga Kushtendili/Kuštendil, komuna e Prizrenit/Prizren, bujk, i martuar, pjesëtar i UÇK-së)

Tamili, Milaimi dhe Refkiu kanë qenë pjesëtarë të UÇK-së që nga themelimi i shtabit të saj lokal në **Kushtendil/Kuštendil**. Kohë pas kohe, shkonin në Shqipëri për të transportuar armatimin në Kosovë. Kanë rënë në betejë me forcat serbe, e cila u zhvillua më **1.09.1998**, në pyll përmbi fshatin e tyre. Trupat e tyre kanë mbetur në vendin e rënies deri më 14.09.1998, kur vëllezërit e Milaimit dhe disa bashkëfshatarë i varrosen ato në pyll, në vendin e njëjtë ku ata edhe kanë rënë. Pas lufte, më 15.09.1999, mbetjet mortore të Tamilit, Milaimit dhe Refkiut u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të

Luftës në Landovicë/Landovica.

**Burimet:** deklarata S.S, FDH-26779; deklarata F.T, FDH-26777; deklarata H.S, FDH-26778; *Identity of Three Other Killed Albanians Learned in Prizren*, pasqyra e lajmeve, KIC, 10. 09.1998, FDH-29556; J. Martinsen, *Regjistri..*, FDH-26092.

## Nehat (Safet) Berisha

(1.07.1953, shqiptar nga Lezi/Lez, komuna e Prizrenit/Prizren, punëtor, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

## Bekim (Mahmut) Berisha

(2.07.1971, shqiptar nga Lezi/Lez, komuna e Prizrenit/Prizren, student i teknologjisë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

## Samedin (Mehmet) Emini

(17.05.1975, shqiptar nga Kukovica/Kukovce, komuna e Dragashit/Dragaš, student i drejtësisë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

## Shehadin (Sherif) Berisha

(15.10.1978, shqiptar nga Lezi/Lez, komuna e Prizrenit/Prizren, punëtor, i martuar, pjesëtar i UÇK-së)

Në verën e vitit 1998, në fshatin Lez gjendshin afro 30 pjesëtarë të UÇK-së, kryesisht nga fshati. Ditën e hënë, më 31.08.1998, forcat serbe e vendosën rrethimin e Lezit/Lez, ndërkaq të martën në mëngjes, më **1.09.1998**, nga ora 8:00, e filluan bombardimin e pozicioneve të UÇK-së të përqendruara në kodrat përreth fshatit. Fshatarët i braktisën shtëpitë e veta dhe kaluan në Lubiqevë/Ljubičevo. Rreth orës 10:00, këmbësoria serbe arriti pranë pozicioneve të UÇK-së, që gjendeshin te vendi i quajtur *Livadhet te Lavdica* [Lez]. Një predhë ka rënë në istikamin ku gjendeshin Nexhati, Samedini, Bekimi dhe Shehadini. Që të gjithë u vranë në vend. Pas dite, këmbësoria serbe hyri në fshat nga drejtimi i Kushninit/Kušnin. Shpëtuan vetëm shtatë ushtarë të UÇK-së. Pasi pushuan luftimet, forcat serbe i morën trupat e Nehatit, Bekimit dhe Shehadinit, dhe, së bashku me trupat e katër ushtarëve të tjerë të UÇK-së [të shikohet regjistrimi në vijim], i bartën në morgun e Prizrenit/Prizren. Policia serbe i ka dorëzuar trupat e Nehatit, Bekimit, Shehadinit dhe pjesëtarëve të